Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2023/0575

Paneli Shqyrtues, duke vendosur në përbërje individuale nga Vedat Poterqoi – Kryetar, në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) lidhur me ankesën e Operatorit Ekonomik (OE) SHTEPIA G SH.P.K., kundër Vendimin për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit të KOMUNA E PEJES në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit Renovimi i shkollave ne Komunen e Pejes LOT 1- Renovimi i qerdhes "Pellumbat e Paqes" renovimi i qendres rrinore ne Dardani dhe ne Shkollen Odhise Paskali LOT 2- Shtruarja e dyshemes nga materiali epox ne Shkollen Rifat Gjota LOT 3- Instalimi i ngrohjes dhe ftohjes ne Shkollen e Muzikes LOT 4- Renovimi i shkolles "Hil Mosi – Jabllanic punotria ne shkollen Rifat Gjota dhe Dardania 3 LOT 5 Regullimi i murit rrethues ne shkollat Migjeni, 2 Koriku , dhe Skender Qeku LOT 6- Renovimi ne s me numër të prokurimit 635-23-6441-5-2-1, me 01/11/2023, mori

Vendim

1. Përfundon procedura e shqyrtimit në ketë çështje administrative, për shkak të pajtimit të arritur mes palëve, Komuna e Pejes nga cilësia e autoritetit kontraktues dhe "Shtepia G" SH.P.K. , e parashtruar në Organin Shqyrtues të Prokurimit me 14.08.2023 (me numër protokolli 575/23) për aktivitetin e prokurimit me titull: "Renovimi i shkollave ne Komunën e Pejes LOT 1 – Renovim i Qerdhes " Pellumbat e Paqes" renovimi i qendrës rinore ne Dardani dhe ne Shkollen Odhise Paskali LOT 2 – Shtrurja e dyshemesë nga materiali epox ne Shkollen Rifat Gjota LOT-3 Instalimi i ngrohjes dhe ftohjes ne Shkollën e Muzikës LOT 4 – Renovimi i Shkolles "Hil Mosi – Jabllanice punëtoria ne shkollën Rifat Gjota dhe Dardania 3 LOT 5 Rregullimi i murit rrethues ne shkollat Migjeni, 2 korriku, dhe Skender Qeku LOT 6- Renovimi ne shkollën 8 marsi, Lidhja e Prizrenit dhe Shaban Spahija" me nr. të prokurimit:635-23-6441-5-2-1.

2. Lejohet kthimi i mjeteve të depozituara në emër të tarifës ankimore sipas paragrafi 4, 5, të nenit 31 të Rregullores së Punës së OSHP, kurse ankuesi ka të drejtë që sipas paragrafi 6, të dispozitës së cituar, të kërkoj kthimin e mjeteve në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, në të kundërtën mjetet konfiskohen dhe kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale –

Me 22.06.2023, Komuna e Pejes , në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar njoftimin për kontratë për aktivitetin e prokurimit me titull: "Renovimi i shkollave ne Komunën e Pejes LOT 1 – Renovim i Qerdhes " Pellumbat e Paqes" renovimi i qendrës rinore ne Dardani dhe ne Shkollen Odhise Paskali LOT 2 – Shtrurja e dyshemesë nga materiali epox ne Shkollen Rifat Gjota LOT-3 Instalimi i ngrohjes dhe ftohjes ne Shkollën e Muzikës LOT 4 – Renovimi i Shkolles "Hil Mosi – Jabllanice punëtoria ne shkollën Rifat Gjota dhe Dardania 3 LOT 5 Rregullimi i murit rrethues ne shkollat Migjeni, 2 korriku, dhe Skender Qeku LOT 6- Renovimi ne shkollën 8 marsi, Lidhja e Prizrenit dhe Shaban Spahija" me nr. të prokurimit:635-23-6441-5-2-1 Nderkaq me datën 28.07.2023 eshte publikuar njoftimi mbi vendimin e AK.

OE"Shtepia G"SH.P.K. me datën 02.08.2023 ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim në AK. AK-Komuna e Pejes me vendim ka refuzuar kërkesën per rishqyrtim te OE"Shtepia G" SH.P.K. lidhur me aktivitetin e prokurimit "Renovimi i shkollave ne Komunën e Pejes LOT 1 – Renovim i Qerdhes " Pellumbat e Paqes" renovimi i qendrës rinore ne Dardani dhe ne Shkollen Odhise Paskali LOT 2 – Shtrurja e dyshemesë nga materiali epox ne Shkollen Rifat Gjota LOT-3 Instalimi i ngrohjes dhe ftohjes ne Shkollën e Muzikës LOT 4 – Renovimi i Shkolles "Hil Mosi – Jabllanice punëtoria ne shkollën Rifat Gjota dhe Dardania 3 LOT 5 Rregullimi i murit rrethues ne shkollat Migjeni, 2 korriku, dhe Skender Qeku LOT 6- Renovimi ne shkollën 8 marsi, Lidhja e Prizrenit dhe Shaban Spahija" me numër te prokurimit: 635-23-6441-5-2-1 inicuar nga –Komuna e Pejes

I pakënaqur me vendimin e AK-së, OE ankues"Shtepia G" SH.P.K. me datën 14.08.2023 ka parashtruar ankesë në OSHP, me numër të protokollit 575/23, kundër vendimit të Autoritetit Kontraktues lidhur me aktivitetin e prokurimit të përshkruar si më sipër.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedure te hapur, lloji i kontratës: Pune, vlera e parashikuar e kontratës:363,725.75 €.

Ankesa e OE është ushtruar në pajtim me nenin 109.1, të LPP, sipas të cilit kundër çdo vendimi të marrë nga AK çdo palë e interesuar mund të parashtrojë ankesë pranë OSHP. Meqë OE ka ushtruar po ashtu kërkesë për rishqyrtim, do të thotë se veprimet e të njëjtit i referohen po ashtu dhe nenit 108/A të Ligjit të cituar. Prandaj OSHP konsideron se Ankesa i plotëson kushtet e parapara në kuptim të dispozitave tani më të cituara dhe e njëjta bie nën kompetencat e tij në kuptim të nenit 105, të LPP.

- Vlerësimi dhe administrimi i provave –

Bazuar në veprimet e përshkruara si më sipër, OSHP ka angazhuar ekspertin vlerësues në pajtim me nenin 111, paragrafi 5 të LPP, me detyrë që i njëjti në kuptim të nenit 113 të Ligjit të cituar, ta bëjë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve ankimore, përkitazi me aktivitetin e prokurimit të përshkruar si më sipër. Lidhur me ketë, me 14.08.2023 eksperti shqyrtues ka dorëzuar Raportin e vlerësimit me rekomandimet si në vijim:

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE "Shtepia G" SH.P.K.

Aprovohet, si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik"Shtepia G" SH.P.K. , **Të anulohet** njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim vetëm për LOT 5.

Konstatohet paraprakisht se, raporti i ekspertizës pas plotësimit të tij nga ana e ekspertit shqyrtues, i përmban elementet qenësore sikurse kërkohet me nenin 113, paragrafi 3 të LPP dhe i njëjti është pranuar nga të dyja palët, konform nenit 115 të LPP lidhur me nenin 20 të Rregullores së cituar. Në ketë rast evidentohet se të dyja palët (AK dhe OE) janë në dijeni lidhur me shkresat komplete të kësaj lënde sikurse kërkohet në pajtim me paragrafin 2, të nenit 20 të Rregullores për Punën e OSHP dhe se të dyja palët kanë deklaruar formalisht AK me 30.10.2023 kurse Ankuesi me 23.08.2023 se janë pajtuar me raportin e cituar si më sipër.

Bazuar në të lartcekurat, Paneli konsideron se procedura e shqyrtimit përfundon në këtë fazë, në kuptim të pajtimit (marrëveshjes) së arritur të palëve dhe rrjedhimisht e njëjta ka humbur pretendimin, respektivisht objektin ankimor sikurse kërkohet shprehimisht me dispozitën e nenit 111, të LPP. Me rastin e shqyrtimit të shkresave të kësaj lënde, natyrës dhe qëllimit të sajë, Paneli shqyrtues konsideron se palët mund ti zgjidhin raportet eventualisht kontestuese mes vete në ato raste kur ato në saje të legjislacionit, disponojnë lirisht me të drejtat e tyre. Andaj, paneli shqyrtues nuk është lëshuar fare vlerësim të pretendimeve ankimore por vetëm nxjerrë vendim për përfundimin e procedurës.

Pajtimi i arritur mes palëve nuk bije ndesh me parimet bazë dhe dispozitat e Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës dhe nuk e atakon pavarësinë institucionale të AK saj, për të zgjidhur çështjen kontestuese, meqë e lejon natyra e çështjes në rastin konkret, mes tjerash konform nenit 19 paragrafi 4 të Rregullores se Punës së OSHP-së Nr. 01/2020 (e amandamentuar).

Megjithatë, Paneli ju kujton palëve se në kuptim të nenit 19, paragrafi 4, të Rregullores për punën e OSHP parashihet se, *cituar:* "Në rast se autoriteti kontraktues dhe parashtruesi i ankesës pajtohen me raportin e ekspertit shqyrtues, paneli shqyrtues nxjerrë njoftim që autoriteti kontraktues në afat prej 5 ditësh ta implementoj raportin e ekspertit shqyrtues duke i njoftuar palët në procedurë.

Prandaj bazuar shkurtimisht në të lartcekurat, Paneli Shqyrtues ne pajtim me nenin 105, 116 dhe 117 të LPP-së vendosi si në dispozitv të këtij vendimi.

Kryetar i Panelit Shqyrtues

Vedat Poterqoi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- AK - **KOMUNA E PEJES**
- OE - **SHTEPIA G SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: